

Lushnje, më 18 /03/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES:

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale , Neni 328 " Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve", Neni 328/a "Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike".

KUNDER:

[REDACTED] v. Kryetari Bashkise [REDACTED].
[REDACTED] administrator Njesia [REDACTED]
[REDACTED] v. Drejtor [REDACTED].
[REDACTED] punonjes Kadastre Bashkia [REDACTED]
[REDACTED] Drejtor Kadastre ne Bashkine [REDACTED]
[REDACTED] Drejtor Rajonal i [REDACTED]

DREJTUAR: PROKURORISË SPAK TIRANË

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 dhe 75/a të K.Pr.Penale, si dhe neneve 328, dhe 328/a të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtuar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 dhe 75/a parashikon se:

Neni 280

Marrja dijeni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.